

# SHKRIM SHQIP PARA 2800 VITESH

Prof. Muharrem **ABAZAJ**\*

(Adresuar Akademive të Studimeve Albanologjike Tiranë dhe Prishtinë për të  
thyer heshtjen)

## PËRMBLEDHJE

Sa ta lexojnë titullin e këtij shkrimi, kundërshtarët e tezës pellazgjike të prejardhjes së gjuhës shqipe, do ta kalojnë ayë pa e lexuar, por vetëm me këto fjalë: “Çfarë na prrallis ky? Paskan jetuar shqiptarë para 2800 vitesh në këtë ishull të largët në fund të Egjeut?” Dhe ky dyshim i tyre është logjik. Sepse vërtet në këtë ishull nuk kanë jetuar shqiptarë. Atëhere? Nuk kanë banuar shqiptarët, por pellazgët e lashtë në ishullin e Lemnosit. Dhe ky mbishkrim është bërë në gjuhën e banorëve të atëhershëm të këtij ishulli, në gjuhën pellazgishte. Por pellazgët në lashtësi kanë qenë shtrirë në një territor shumë të gjerë, të ndarë në fise.

**Fjalë kyçe** – pellazg, ilir, fjalë, gjuha shqipe

## HYRJE

Se nga cilët është banuar Lemnosi, ku është gjetur ky mbishkrim, na i thotë historian më i vjetër i lashtësisë, Herodoti. “Ja se si Miltiadi, i biri i Kimonit, ishte bërë zot i ishullit të Lemnosit. Athinasit dëbuan më parë pellazgët nga Atika. A patën të drejtë apo kryen një padrejtësi, nuk kam ndërmend ta përcaktoj, mjafton ajo çka thuhet. Hekateu, i biri i Hegesandrit, tregon në Historitë e tij se kjo qe e padrejtë. Athinasit, thotë ai, duke parë se toka, që ata u kishin lëshuar pellazgëve në këmbët e malit Hymet, si shpërblim për ndërtimin e murit që rrethon Akropolin, ishte punuar mirë, megjithse më parë kishte qenë e keqe dhe e pavlefshme, i dëbuan ata, pa asnjë shkak, vetëm e vetëm prej lakmisë e dëshirës për t’a marrë tokën përsëri.”<sup>1</sup>

## I. MBISHKRIM I LEMNOSIT GJETUR NË ISHULLIN GREK TË LEMNOSIT

Fise me prejardhje pellazge kanë qenë edhe helenët, thrakët, frigët, ilirët, etruskët etj.

---

<sup>1</sup> Herodoti, Historitë, Libri VI, 137, Ilirët dhe Iliria te autorët antikë, f.19

Të gjithë këta fise si gjuhë të tyre patën pellazgishten. Me kalimin e shekujve gjuha e fiseve të ndryshme pësoi ndryshime deri në formimin e gjuhëve të ndryshme.

*\*Akademia e Shkencave “Rrënjët Tona”, Studiuues i gjuhësisë në fushat albanologjike*

Por, të gjitha këto gjuhë ruajtën edhe një substrat nga trunngu mëmë pellazg, substrat që i ka grupuar këto gjuhë në një familje të madhe gjuhësore, në atë indoevropiane. Ilirët, si një bashkësi e fiseve pellazge, patën si gjuhë të tyre pellazgishten. Edhe arbërit, si fis ilir, patën gjuhën e tyre pellazgishten. Mirpo arbërit, duke mos u shkukur kurrë nga trojet e tyre, e ruajtën shumë më mirë se fiset e tjera gjuhën e tyre të lashtë, pellazgishten. Edhe ne shqiptrët, pasardhësit e arbërve, nuk u shkulëm kurrë nga trojet tona dhe e ruajtën shumë më mirë se fiset e tjera gjuhën e të praëve tanë. Sepse gjuha jonë shqipe është vet pellazgishtja në një evoluim të pandërprerë, ne arrijmë që me anën e saj të lexojmë këto shkrime të lashta pellazge.

Mbishkrimi i Lemnosit është gjetur në ishullin grek të Lemnosit, i cili ndodhet në hyrje të Ngushticës së Dardaneleve, në detin Egje. (ruhet në Muzeun e Athinës). Mendohet se i përket shek VIII p.e.s. Mbishkrimi është i gdhendur mbi një pllakë të madhe guri, gur varri.<sup>2</sup> Përpara se të japim deshifrimin e plotë të këtij mbishkrimi, po japim fare shkurt disa veçori kryesore të pellazgishtes. (Këto veçori i kemi shtjelluar gjerësisht në librin “Gjuha e lashtë shqipe (pellazgishtja).” Gjuha pellazge ka qenë njërrrokëshe. Fjalët e saj kanë patur trajta të ngura, pasi pellazgishtja nuk ka patur elemente gjuhësore që i japin fleksibilitet fjalës, siç janë parashtesat, prapashtesat, mbaresat, nyjet. Kjo bënte që një fjalë të merrte disa kuptime dhe dallimi bëhej vetëm nga konteksti. Kështu fjala mar/marr merrte kuptimin e foljes **marr**, të mbiemrit **mar**, i **mbarë**, të mbiemrit **i marrë** (çmendur) etj. Fjala **di** mund të merrte kuptimin e foljes **di**, të numërorit di/**dy**, të bagëtisë, **di/dhi** etj.

Pellazgishtja ka patur alfabetin e saj i cili në letëratore njihet si alfabeti fenikas. Shkrimi pellazg ka karakter linear, ai nuk ka patur ndarje midis fjalive dhe fjalëve nga njëra – tjetra. Gjithashtu shkrimi pellazg ka qenë i tipit busdofedik, sipas të cilit shkrimi fillon nga ana e djathtë dhe, kur kalon në rreshtin tjetër, ndërron drejtim, fillon nga e majta e kështu përsëritet rresht pas rreshti. Duke qenë një përkushtim mbi një gur varri, mbishkrimi ka një numër të kufizuar fjalësh, por e rëndësishme është se këto fjalë, ose janë rrenjë të fjalëve korresponduese të shqipes së sotme, ose janë identike me to. Fjalët shqipe që kemi identifikuar në këtë mbishkrim emra trajta e lashtë      trajta e sotme  
ar                      arë

---

<sup>2</sup>Muharrem Abazaj, Pellazgët kanë folur dhe shkruar shqip, v.2012

fis	fis lot
lot thik	thikë
var	varr
et	jetë.

mbiemra

zi	i zi
math	i madh
mar	i marrë

Në shqipen e lashtë nuk ka patur mbiemra të nyjshë, përemra

i	ai
i	trajta e shkurtër shem s'i, nuk i

Y atij.

na trajte e bashkuar e përemrit vetor.

Folje

a	asht
as	asht.
is	ish
fan	than, trajtë e geg, me than
ro	rroj,
rom	rrojmë.
ap	hap
ap	jap
mor	mori
hok	hoq. hek, trajtë e geg.
ther	ther
e	je. lidhëza e
e,	dhe se se, lidhëz kushtore. Parafjalë ke ke, trajtë e gegënishtes, te, tek.
m	më
pjesëzë	


s	s,
nuk pasthirmë	
hop.	Hop.

## II. PËRMBAJTJA E MBISHKRIMIT

Një person, i quajtur Maf, ka shkuar tek ara e tij dhe atje ka mbetur i shtangur. Arën e tij e kishin zaptuar disa persona. Mafi bëhet si i marrë. - Nuk ja u jap atyre – thotë - është ara jonë fis pas fisi. U kërkon zaptuesëve t' ia kthejnë tokën. Ata nuk pranojnë. Aty vjen edhe vëllai i tij, Tafi. Toni i kërkesës së tyre duket i butë, Ata u thonë se ju jini fis, jini fis i madh, se ata me këtë tokë rrojnë. Aty hapin varret. Zaptuesit përsëri nuk pranojnë. Atëhere vëllezërit vendosin të qëndrojnë aty, në mbrojtje të pronës së tyre. Me sa kuptohet ka patur përleshje midis tyre. Vëllai i madh, Mafi, duket është vrarë (therur). prej zaptuesëve të tokës së tyre. Kjo duket nga fjalët.” *Lot ai fis hoqi. Ti na there.*” Në krah të portretit në gur është skicuar një thikë, si për të treguar shkakun e vdekjes së personit të varrosur aty, të cilit i është shkruar ky përkushtim.

Për ata që do të duan të ndjekin deshifrimin, po japim disa sqarime. Edhe pse fillimi i shkrimit nis nga e djathta, dhe ky drejtim ndërron për çdo rresht, ne e kemi bërë fillimin e çdo rreshti si të filluar nga e majta. Çdo rresht e kemi paraqitur ashtu si ka qenë i shkruar në pellazgjisht. Shkrimi pellazg nuk ka patur ndarje midis fjalive dhe fjalëve, gjë që paraqet shumë vështirësi në ndarjen e tyre. Më pasë e kemi ndarë atë në fjalë. Çdo fjalë pellazge e kemi transkriptua (kemi zëvendësuar çdo shkronjë të alfabetit pellazg me shkronjën korresponduese të alfabetit shqip.). Më pas kemi shqyrtuar seicilën fjalë veçmas duke e krahasuar atë me fjalë të shqipes së sotme. Shkurtimisht kemi treguar evolucionin e fjalëve pellazge deri në trajtat e shqipes së sotme mbështetur në ligjet fonetike të shqipes. Në mbarim të deshifimit të çdo rreshti, japim përmbajtjen në gjuhën shqipe dhe më pas i bëjmë një koment të shkurtër përmbajtjes së tij.

## **Deshifrimi**



I Z I A Z I

1 **Zi** ZI - **zi**. Fjala **zi**, si çdo fjalë e ngurtë njerërore pellazge, mund të ketë disa kuptime. Ajo mund të jetë emër personi. Emra të tillë njerëzish kemi edhe sot në Shqipëri **Ziu**, por në dallim nga ky emër i lashtë, në shqip ai ka edhe nyjen e prapme /u/, të cilën pellazgjishtja nuk e ka disponuar. Fjala **zi** mund të ketë edhe kuptimin e emrit **zi**, vajtim, të mbiemrit **i zi**. Se me cilin kuptim është përdorur kjo fjalë, ne do ta saktësojmë duke e parë atë në kontekstin e fjalive të mëposhtme.

2 **A** A - **a** Fjala **a** = fol. **a** e shqipes, por në trajtën e vjetër të dial. geg. **a** (asht).

3 **Zi** ZI - **zi**. Nuk arrijmë të zbulojmë plotësisht kuptimin e fjalës **zi** dhe arsyen pse ajo është përdorur dy herë. Po hamendësojmë sikur herën e parë fjala **zi** të jetë përdorur në kuptimin e emrit të një personi, të **Ziut**, kurse herën e dytë në kuptimin e mbiemrit **i zi**. Në se hamendësimi ynë do të ketë qenë i drejtë, atëhere do të kishim këtë përmbajtje: “Ziu është i zi”. Del sikur stigmatizohet një person i quajtur Zi. Përse? Do të mund ta zbulojmë më poshtë.

I **MADAC** **AF**

I

**MAD**

1 MAR – **mar**. Kjo fjalë mund të ketë disa kuptime: mund të ketë kuptimin e foles **marr** në shqip, por edhe të mbiemrit **i marrë**. Se me cilin kuptim është përdorur në këtë rast, do të mund ta shohim përsëri në kontekst me fjalët e mëposhtëme.

2 AS – **as**.> fol. **asht** dial. geg. Ajo ka ndjekur këtë evolucion: as > ast > asht.

3 MAF – **Maf** Fjala **Maf** përqaset me ndajfoljen *mjaft* të shqipes, por mund të jetë edhe emër personi, person me emrin **Maf**. Le të vazhdojmë me hamendësim deri sa të zbulojmë kuptimin e saktë përmes kontekstit. Në se fjala *mar* do të ketë kuptimin e foljes **marr** dhe fjala *maf* të ndajfoljes **mjaft**, atëhere do të delte kuptimi: “*marr asht mjaft*, ndërsa po qe se fjala *mar* do të ketë kuptimin e mbiemrit **i marrë** dhe fjala *Maf* ka patur kuptimin e emrit **Maf**, atëhere kuptimi do të delte: “*I marrë asht Maf -i ose si i marrë asht Maf - i*. Na duket më bindës rasti i dytë (*Si i marrë asht Maf-i*).

Koment: Një person i quajtur *Maf*, është bërë *si i marrë*.

### III SI – **si** I

1 SI – **si**. = ndf. **si** e shqipes, por përqaset edhe me psz. mohuese **s**, të shoqëruar nga trajta e shkurtër e përemrit vetor **i**. (**s'i**) njësoj si në gjuhën shqipe.

2 AP- **ap**.> fol. > **jap**, por përqaset edhe me em. **hap** (masë gjatësie)

3 Y – y > Pellazgjishtja nuk e ka disponuar zanoren **y**. Kjo zanore ka dalë më vonë si një refleks i zanores **i**. Përemri vetor i vetës së tretë **ai**, në pellazgjisht është shprehur vetëm me zanoren **i**, por duke qenë se në këtë rast ky përemër është dashur të përdorej në rasën dhanore *atij*, autori mund ta ketë shprehur këtë me anën e një ndryshimi grafik të **i** -se

4 FE IS – **fe is**. Këtu kemi trajtën e përbërë të foljes *tha*, pasi shpreh një veprim të ndodhur në të kaluarën. Trajta **fe** ka evoluar në **the**, (f < th). Folja **is** ka evoluar në **ish**. (s > sh.). Del folja *the ish*, por sipas rendit të fjalëve të shqipes, kemi *ish the*, e cila do kuptuar si “*ish thenë / kish thënë*”. Shohim se në këtë rast është përdorur trajta e dial. geg, sipas së cilës në vend të foljes ndihmëse *kam*, pëdoret folja *jam*. Kështu në geg. thuhet *ishte lindur*, kurse në tosk. thuhet *kishte lindur*.

.6 A – **a**. = **a**, asht.

7 FIS – **fis**. = em. **fis**. Me këtë trajtë të ngurtë emri *fis* mund të shprehë të gjitha kuptimet gramatikore: numrin njëjës dhe shumës, trajtën e pashquar dhe të shquar, të gjitha rasat. Duke i renditur fjalët e kësaj fjalije sipas kuptimeve të përqasura, do të kemi disa variante, por variant më bindës duket se është:

(S'i jap atij, thoshte. Asht e fisit).

Tani na vjen plotësisht në ndihmë konteksti për të sqaruar kuptimin e fjalive të mësipërme. Mafi i egërsuar flet përçart: - S' ia jap atij- thotë. Asht e fisit. - Çfar i kërkohet atij që e ka tronditur aq shumë? Tani kuptohet pse në titull të mbishkrimit shkruhet: - Ziu është i zi -, pasi ai, **Ziu**, do t'i ketë kërkuar ose do t'i ketë rrëmbyer Mafit ndonjë objekt jetik, të cilën ai s'do të pranonte kurrë t'ia jepte.

#### IV **EF** **SE** **RO** **NA** **I**

1 **E** E – **e**. = lidh. **e** e shqipes, por dhe trajtë e shkurtër **e** pr. vetor, por mund të jetë edhe fol.> **je**. Bashktingëlloren **j** nukë gjejmë të shkruar në asnjë mbishkrim që kemi deshifruar

2 **F** **FIS** – **fis**. = em. **fis** në shqip.

3 **SE** SE – **se**. = lidh. shkakore **se** e shqipes.

4 **RO** – **ro**.> fol. **rroj** të shqipes. r < rr

5 **NA** NA – **na**. = trajtë e bashkuar **na** e përemrit vetor të shqipes.

6 **IP** IP – **ip**.> fol. **jip** të shqipes.

(*Je fis, se rroj, na i ip*). Mafi i drejtohet Ziut me fjalët, - *je fis*. Ai do ta prekë atë në sedër duke i kujtuar zakonet fisnore. Ai i thote se me këtë rroj, prandaj nuk ta jap. Për ne tani bëhet e qartë se çfar i është marrë Mafit. Atij i është zaptuar toka, ara me të cilën rron, e cila e ka tronditur shumë. Ai përpiqet të jetë i qetë në kërkesën e tij për t'ia kthyer atë.

#### V **SI** **FA** **I**

1 **SI** SI – **si**. = ndf. **si**, por edhe lidh. **si** e shqipes.

2 **FA** FA – **fa**.> fol. **tha** e shqipes. (f > th).

3 **II** – **i**.> pr. vetor **ai** i shqipes. (shih. III.3)

(Si tha ai?). Çfar përgjigje i dha zaptuesi Mafit?)

VI **AKËFTAF** I  
0

1 **A** A – **a**.> *asht*, por edhe pjesëzë trguese **ja** e shqipes.

2 **K** K – **k**.> par. **ke** të shqipes, dial. geg. Në tosk. **te**, **tek**.

3 **ER** ER – **er**.> fol. **erdh** e shqipes. (er > erd > erdh).

4 **TAF** TAF – **Taf**. Emër personi. Mund të jetë vëllai I Mafit.

5 **AR** AR – **ar**. = emr. **ar**(ë) të shqipes.

6 **ZI** I ZI – **Zi**. përsëritje e emrit **Zi**.

7 **O** O – **o**. ka kuptimin e pasthirmës **o** të shqipes, por këtu rendi i saj ndryshon nga ai i shqipes, pasi vendoset pas emrit.

(Ja *erdh Taf, në arë, Zi.o.*) Ardhja aty në arë e Taf -it, me sa duket vëllait të Mafit, e ka fuqizuar atë, prandaj edhe ia kujton këtë gjë Ziut, me qëllim që ai t'ua rikthejë atyre arën.

VII **FAN** I **AP** I **SE** I **RO** I

1 **FAN** FAN – **fan**.> fol. **than**, e dialektit të geg, **me than**.

2 **AP** AP – **ap**.> fol. **jap** të shqipes.

3 **A** A – **a**.> fol. **a**, *asht*.

I

4 **SI** SI – **si**.>psz. mohuese **s** dhe trajta e shkurtër e pr vetor.**i.(s' i )**

5 **AP** AP – **ap**. = fol. **jap**.

6 **SE** SE - **se**. = lidh. **se**.

7 **RO** RO – **ro**.> fol. **rroj**.



8 NA – **na.** = trajtë e bashkuar të përemrit vetor **na**, shih.rreshtin IV.5

9 I MOR – **i mor** < trajta e shkurtër e pr. vetor **i** dhe folja **mori** e shqipes.

10 I I – **i.** > pr. vetor të vetës së tretë **ai** (shih.III.3)

11 NA – **na.** = trajtën e bashkuar të pr. vetor **na**.

12 IP- **ip.** > fol.

**jip**

(*Thanka me ja dhanë, s'ia jap, se rroj. Na i mori! Na i jip!*). Edhe vëllai i Mafit, Tafi, sapo njeh qëllimin e zaptuesit për t'u marrë tokën, e kundërshton atë me forcë, - s'ia jap thotë, se rroj. Mirpo, sakaq, zaptuesi e ka bërë fakt rrëmbimin e tokës së tyre. Ata akoma nuk po e besojnë se po e humbasin përgjithmonë tokën e tyre, prandaj vazhdojnë t'i kërkojnë zaptuesit t'ua japë atë.

VIII HOP – **hop**

1 HOP – **hop.** = pasth. **hop** të shqipes.

2 a folja **asht**.

I I – **i.** = pr. vetor **ai**.

3 ES – **es.** > fol. **esht** e shqipes. Evoluimi i saj ka qenë: es < est < esht.

4 MATH – **math.** > mbi. **i math** / i madh të shqipes.

6 O – **o.** = pasth. **o** të shqipes.

(*Hop. Ai është i madh, o.*) Edhe pse vëllezërit Maf e Taf e shohin me syt e tyre zaptimin e tokës, ata sikur nuk e besojnë ende, flasin përçart: - Hop, Hidhu, (na i jep), - sikur t'i urdhërojnë zaptuesit. Por gradualisht janë duke u kthjelluar. Ata janë të ndërgjegjshëm se zaptuesi është më i fortë se ata (*ai esht i madh, o*).

IX SI – **si**

1 SI – **si.** = ndf. **si** e shqipes.

2 **FA** – **fa.** > fol. **tha** e shqipes.

3 **II** – **i.** > për. **ai.** i shqipes. (shih.III.3)

4 **A** – **a.** = **a.** (asht).

**F**

**S**

5 **FIS** – **fis.** = emr. **fis.**

6 **SI** – **si.** > psz. **s,** dhe trata e shkurtër e pr vetor **i.** (**s'i**) shih. III.1 dhe VII.4

7 **AP** – **ap** > fol. **jap** e shqipes. (shih. rreshti III.2).

8 **Y** – **y.** > pr. vetor **atij,** (shih. rreshtin III.3.)

9 **FIS** – **fis.** = em **fis.**

10 **M** – **m.** > parf. **më** të shqipes. Kjo parafjalë ka patur këtë evoluim: **m > mb >**

**mbë > më.**

11 **AR** – **ar.** = em. **arë** të shqipes.

12 **ASM** – **asm.** > fol. *jemi* të shqipes. Ajo është e njëjtë me foljen **as** (asht) por ka edhe mbaresën **m** të numrit shumës të vetës së parë.

13 **O** – o pasth. **o.**

14 **M** – **m.** > parf. **me** të shqipes.

15 **IAI** – **ai.** = pr. vetor **ai** të shqipes, por në këtë kontekst ai është në rasën kallzore, prandaj nuk e ka ruajtur trajtën e rasës emnore **i.**

16 **ROM** – **rom.** > fol. **rrojmë** e shqipes. Edhe këtu dallojmë mbaresën foljore **m.**

(*Si tha. Asht e fisit. Nuk ia japim fisit të atij. Në arë do të jemi o. Me atë rrojmë*)  
Si iu përgjigj kërkesës së vëllezërve zaptuesi? Ai thotë se ajo arë është e

fisit të tij. Po vëllezërit nuk tërhiqen, ata vazhdojnë të këmbëngulin se nuk do t'ia japin fisit të tij. Nuk do të largohen nga ara e tyre, këtu do të rrimë, - thonë. Nuk kanë zgjidhje tjetër, se me atë **rrojnë**.

X **VARR** I O **SE** M I **ESAP** M **YQ** O **KE**

1 **VAR** HAR - **har.**> em. **varr**

2 **AP** AP - **ap.**> në këtë kontekst, ka kuptimin e fol. **hap** të shqipes.)

3 **I I** - **I.**> pr. **ai** të shqipes. (shih. III.3)

4 **O** O - **o.** pasth **o.**

5 **I SI** - **si.** = lidh. **si**

6 **FA** FA - **fa.**> fol. **tha.** (f < th).

7 **I I** - **i.**> pr. vetor **ai.**

8 **ET** ET - **et.**> em. **jetë**

9 **I I** - **i.**> pr. vetor **ai.**

10 **ES** ES - **es.**> fol. **esht** të shqipes. (Zanoren ë pellazgjishtja nuk e ka patur).

11 **I I** - **i.**< pr. **ai.**

12 **O** O - **o** = pasth. **o**

13 **AR** AR - **ar.**= em. **arë**

14 **A** A - **a.**= fol. **a**( asht ).

15 **Y** - Y - **y.**> pr. vetor **ai.**

16 **TIK** - **tik.**> em. **thikë** të shqipes.  
I K

17 **HOK** - **hok** > fol. **hek** / **hoqe** të shqipes në dial.geg.

18 E - e.> fol. **je**.

*(varret hapim.o. Si tha ai? Për jetë ajo esht e tij? Ara është e tij? Thik na hoqe.)*

Jo vetëm se me këtë arë ata sigurojnë jetën e tyre, por në këtë arë, në këtë tokë, ata hapin varret. Prania e varreve në atë tokë provon më së miri se toka që po u grabitet ka qenë pronë legjitime e tyre, sepse aty janë varret e të parëve të tyre, aty do të hapin edhe varre të tjera, edhe varret e tyre. Varret për ta kanë qenë të shenjta. Ata nuk mund të largoheshin nga varret e njerëzve të tyre të dashur. Kjo traditë e herëshme e paraadhësve tanë është ruajtur edhe nga ne shqiptarët. Kjo “ngulje e përjetëshme” në këto troje ku jetojmë sot, tregon fare qartë pse kemi një vazhdimësi gjuhësore pellazgo – iliro – shqipe.

XI **LOT** ES **LOT** I **AS** SE **PC** I **RESPONA**

**SI**

1 **LOT** LOT - **lot**. = em. **lotë**.

2 **A** A - a. = fol. **a**, asht.

3 II - **i**.> pr. **ai**.

4 **E** E - **e**.> fol.

**je**

5 **ZI** I ZI - **zi** = em. **zi**, vajtim.

6 **HOK** HOK - **hok**. = fol. **hok**, hoqi.

7 II - **i**.> pr. **ai**.

8 **AS** I AS I - **as i**. = lidh. **as** dhe trajtën e shkurtër të pr, vetor atij. **i**

9 **AP** AP - **ap**.> fol. **jap**.

10 **E** E - **e**.> fol.

**je**.

11 **SE** SE - **se**. = lidh. shkakore

**se**.

12 **RO** RO - **ro**.> fol. **rroj**.

13 **NA** A - **na**. = fol. **a**, asht.

14 **IP** IP - **ip**.> fol. **jip**.

15 **E** E - **e**.> fol.

**je**.

16 **FIS** FIS - **fis**. = em. **fis**.

17 **TI** TI – **ti.**= pr. vetor

**ti.**

18 **FER** FER – **fe.**> fol. **ther.** (f > th)

19 **O** O – **o.**= pasth.**o.**

20 **NA** NA – **na.** shih.IV.5

*(Lot e zi ai fis hoqi. Nuk na i dhe, edhe se me të rrojmë. Na i jep. Je fis ti. Na there.)*

## **SË FUNDMI**

*Do t'ju lutëm të gjithë ju miqëve të mij studjues të gjuhës shqipe që kini gjetur kohë për ta ndjekur deri në fund këtë deshifrim, në se keni krijuar bindjen se kjo ka qenë gjuha e vjetër shqipe, publikojeni me mjetet tuaja, sepse i bëjmë një shërbim të madh kombit, dhe nëse ka vend për diskutime për fjalë të veçanta apo problem të tjera, t'i diskutojmë bashkarisht.*